

VENDIM
Nr. 72, datë 17.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.10.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 2 (D) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: DASHAMIR ALSULA

SUBJEKT I INTERESUAR: Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatja e shtetit Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2023-5594, datë 22.12.2023; nr. 00-2023-2236, datë 24.4.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për pjesën që është vendosur dënimi me gjobë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 27, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Dashamir Alsula, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarshi ushtron detyrën e avokatit të shtetit, i caktuar në Ministrinë e Brendshme, në zbatim të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar (*Ligji për Avokaturën e Shtetit*). Në datën 25.11.2022, ai ka nënshkruar rekursin ndaj vendimit nr. 398 (86-2022-545), datë 21.10.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Ministrisë së Brendshme, duke kërkuar që Gjykata e Lartë të vendoste “prishjen e vendimit nr. 398 (86-2022-545), datë 21.10.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, me tjetër trup gjyqësor”.

2. Çështja gjyqësore, në të cilën është paraqitur rekursi, i përkiste një punonjësi të Policisë së Shtetit, i cili kishte paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me objekt shfuqizimin e vendimit

për dhënien e masës disiplinore të përjashtimit nga policia. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2465 (80-2020-2450), datë 19.10.2020, ka shfuqizuar vendimin për dhënien e masës dhe ka detyruar palën e paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 12 paga mujore. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 398 (86-2022-545), datë 21.10.2022. Në pikën 2 të dispozitivit ajo gjykatë është shprehur se kundër vendimit lejohej rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Në përfundim, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me shkresën e datës 25.11.2022, e ka dërguar rekursin e nënshkruar nga kërkuesi në Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo e fundit ka vendosur pranimin e rekursit dhe e ka përcjellë atë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

4. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2236, datë 24.4.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit dhe dënimin e kërkuesit, në cilësinë e avokatit të shtetit, me gjobë në masën 50 000 lekë. Kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar revokimin e dënimit me gjobë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5594, datë 22.12.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës.

5. Në datën 7.3.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, në datën 3.5.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, në datën 27.5.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

6.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtat e aksesit në gjykatë dhe ankimit efektiv, pasi Gjykata e Lartë e ka dënuar pa argumentuar bazën faktike. Rekursi nuk ka pasur asnjë shkelje në përmbajtje të normave të së drejtës, të logjikës dhe të të argumentuarit normal të kundërshtimit ndaj vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta. Rekursi nuk ka pasur përmbajtje shpifëse dhe nuk ka manipuluar faktet për të çuar gjykatën në gabim, kurse gjuha e përdorur ka qenë juridike dhe aspak abuzive, duke pasur për qëllim të vetëm mbrojtjen e interesave të shtetit dhe të së drejtës.

6.2 *E drejta për të mos u dënuar pa ligj*, e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi dhënia e gjobës përbën një regjim dënimi për kërkuesin, i cili është penalizuar në mënyrë të paligjshme. Avokati i shtetit nuk mund të jetë subjekt i penalizimit me gjobë, sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sepse përfaqëson me autorizim Avokaturën e Shtetit, e cila si person juridik publik përfaqëson dhe mbron interesat e shtetit, në rastin konkret të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Gjykata e Lartë ka dalë jashtë kompetencave funksionale dhe fushës së veprimit të dispozitave të KPC-së. Në ligj nuk parashikohet që gjykata të japë masa disiplinore ndaj nëpunësit publik për shkak të ushtrimit të funksionit. Neni 34 i KPC-së nuk mund të përdoret për të disiplinuar avokatin e shtetit, kur ai nuk ka keqdashje ndaj procesit ose përfitim personal të drejtpërdrejtë, në të kundërt, gjykata duhet të njoftojë organin që përfaqëson nëpunësi publik.

7. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

7.1 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit efektiv* është i bazuar. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndaj kërkuesit barrë joproporcionale, që nuk respekton balancën midis qëllimit legjitim për të garantuar respektimin e kushteve formale për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, nga njëra anë, dhe së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, nga ana tjetër. Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte se përse rekursi dëmtonte procesin e dhënies së drejtësisë, ku qëndronte pathemelësia haptazi dhe abuzimi në ushtrimin e tij, që solli dënimin me gjobë. Vendimi i Gjykatës së Lartë për caktimin e gjobës ndaj avokatit të shtetit jo vetëm

ka penalizuar kërkuesin për kryerjen e detyrave të tij profesionale, por ka cenuar edhe aksesin në gjykatë, duke krijuar frikë, precedentë të rrezikshëm dhe barriera administrative për institucionet shtetërore dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë.

7.2 Kërkuesit i është cenuar *e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, sepse përfaqësimi është kryer prej tij bazuar në vullnetin e institucionit të përfaqësuar – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, sipas Ligjit për Avokaturën e Shtetit. Qëllimi i ligjvënësit për miratimin e nenit 34 të KPC-së ka qenë penalizimi i palës ose përfaqësuesit të drejtpërdrejtë dhe jo i shprehësit të vullnetit të përfaqësuesit. Gjoka e vendosur nga Gjykata e Lartë rëndon mbi një subjekt të së drejtës publike, të cilit ligji nuk i ka dhënë tagra disponimi, për rrjedhojë nuk është i autorizuar të vendosë për të mos ushtruar të drejtën e rekursit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në rastin konkret, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka marrë pjesë në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, në të cilin është vendosur dënimi i tij me gjobë, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet asaj me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*sibih vendimet nr. 22 datë 4.4.2024; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar në Gjykatën e Lartë vendimin gjyqësor të po asaj gjykate për mospranimin e rekursit, në pjesën që e ka dënuar atë me gjobë, duke kërkuar revokimin e gjobës, por kërkesa e tij nuk është pranuar. Në këto rrethana, kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion për t'u ankuar, për rrjedhojë Gjykata çmon se ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

12. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë që nuk ka pranuar ankimin e tij ndaj dënimit me gjobë, mban datën 22.12.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 7.3.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

13. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe së drejtës për të mos u dënuar pa ligj. Për sa i takon kësaj të fundit, Gjykata vëren se garancitë e nenit 29 të Kushtetutës, të cilat i referohen dënimit për veprat penale, sipas legjislationit procedural dhe material penal, nuk janë të zbatueshme në rastin e caktimit të gjobës nga gjykatat e zakonshme, sipas nenit 34 të KPC-së. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim *ratione materiae*.

14. Për sa i përket së drejtës për proces të rregullt ligjor, kërkuesi ka parashtruar se vendimi i caktimit të gjobës ndaj tij nuk ka respektuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit dhe ankimit efektiv, sipas garancive të neneve 17, 42, 43 dhe 142 të Kushtetutës. Subjekti i interesuar është shprehur se ankimi kushtetues individual i kërkuesit duhet të pranohet, pasi gjoba e caktuar ka deformuar rëndë statusin e avokatit të shtetit, ndëshkimi i avokatëve të shtetit krijon pabarazi në qasjen e institucioneve shtetërore në gjykatë, duke krijuar frikë, precedentë të rrezikshëm dhe barriera administrative për institucionet shtetërore dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre.

15. Gjykata vëren se kërkuesi është avokat i shtetit dhe ka paraqitur rekurs në përmbushje të detyrës së tij, e cila rregullohet me ligj të posaçëm dhe i jep status të veçantë atij. Gjykitja e avokatit të shtetit, i cili vepron në emër dhe për llogari të institucioneve publike, ka një ndikim të dyfishtë, pasi, nga njëra anë, ndikon në të drejtën ligjore për të përmbushur detyrën e avokatit të shtetit, sipas ligjit, dhe, nga ana tjetër, ndikon në të drejtën e institucioneve shtetërore për të paraqitur ankim dhe për të pasur akses në gjykatë. Për sa i takon vlerës së gjobës, Gjykata vëren se shuma prej 50 000 lekësh e caktuar ndaj kërkuesit nga Gjykata e Lartë nuk është e vogël në raport me pagën e tij si zyrtar shtetëror.

16. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se në një rast të mëparshëm ajo nuk ka pranuar ankimin kushtetues të avokatit, në profesion të lirë, kundër vendimit gjyqësor të gjobitjes me 10 000 lekë për shkak të abuzimit me të drejtat në procesin gjyqësor, sipas nenit 34 të KPC-së. Sipas Gjykatës, gjoba me vlerë jo të lartë nuk përcaktonte të drejtat civile të avokatit për të ushtruar profesionin, nuk prekte reputacionin e tij dhe nuk ishte në vetvete e mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës (*shih vendimin nr. 22, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë faktin se kërkuesi ka vepruar në përmbushje të detyrës zyrtare, efektet e përgjithshme të gjobës ndaj të drejtave për ankim dhe akses në gjykatë të institucioneve që përfaqësohen nga avokati i shtetit, si dhe vlerën jo të parëndësishme të gjobës së caktuar ndaj tij, që janë rrethana të ndryshme nga rasti i mësipërm, çmon se çështja konkrete hyn në sferën e nenit 42 të Kushtetutës. Ndaj, në vijim, ajo do të analizojë respektimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, në kushtet kur kërkuesi ka vepruar si përfaqësues i institucionit publik i autorizuar nga ligji, pra nuk ka qenë bartës i drejtpërdrejtë i të drejtave për ankim dhe akses në gjykatë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se ku qëndronte pathemelësia dhe abuziviteti i rekursit, në kushtet kur rekursi ka qenë i rregullt në formë dhe në përmbajtje të normave të së drejtës, të logjikës dhe të të argumentuarit normal të kundërshtimit ndaj vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta. Gjykata e Lartë në vendimin e mospranimit është bazuar në standardin minimal të arsytimit që është paraqitja e shkaqeve të rekursit të parashtruara nga Avokatura e Shtetit.

19. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka mbajtur qëndrimin se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara, pasi Gjykata e Lartë nuk ka përmbushur standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe nuk ka argumentuar se cilat nga kriteret e nenit 34 të KPC-së nuk janë respektuar në rekursin e nënshkruar nga Avokatura e Shtetit. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka krijuar paqartësi, pasi bazohet vetëm në një qëndrim deklarativ, duke mos u dhënë përgjigje shkaqeve të paraqitura në kërkesën ankimore lidhur me dënimin me gjobë. Sipas subjektit të interesuar, Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte

se përse mjeti i ushtruar dëmton procesin e dhënies së drejtësisë dhe ku qëndron pathemelësia haptazi dhe abuzimi në ushtrimin e tij, ndaj mënyra e zbatimit të ligjit nga ajo gjykatë është e paarsyetuar.

20. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i vendimit gjyqësor është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar duke u dhënë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Lidhur me arsyetimin e vendimeve të mospranimit të rekursit, jurisprudenca kushtetuese është shprehur se dhoma e këshillimit njihet dhe si faza seleksionuese për shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit dhe duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 26, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi dhe subjekti i interesuar parashtojnë se Gjykata e Lartë, në vendimet e saj për mospranimin e rekursit që ka caktuar gjobën dhe për mospranimin e kërkesës për revokimin e gjobës, nuk ka dhënë arsytet se ku qëndron abuzimi me të drejtën në proces i avokatit të shtetit, si përfaqësues i një institucioni publik gjatë ushtrimit të rekursit në emër dhe për llogari të atij institucioni, që, në thelb, përbën detyrim të përcaktuar nga ligji. Në këto rrethana, për zgjidhjen e çështjes së paraqitur, Gjykata pa marrë përsipër të luajë rolin e Gjykatës së Lartë në vlerësimin e (pa)themelësisë së shkaqeve të rekursit, do të verifikojë vetëm nëse ajo gjykatë ka respektuar standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

23. Në këtë këndvështrim, Gjykata konstaton se kërkuesi, gjatë ushtrimit të detyrës së avokatit të shtetit dhe në përmbushje të detyrimeve sipas Ligjit për Avokaturën e Shtetit, ka paraqitur rekurs. Ai ka vepruar mbi bazën e kërkesës me shkrim të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë, kërkesë e cila i është drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe ky i fundit ka urdhëruar me shkrim kërkuесin për nënshkrimin e rekursit (urdhri nr. 430, datë 25.11.2022, "Për nënshkrim rekursi"). Projektrekursi i përcjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë është përpunuar më tej nga kërkuesi, në drejtim të rrethanave, shkaqeve dhe kërimit përfundimtar të tij, duke i kërkuar Gjykatës së Lartë, që në zbatim të nenit 63, shkronja "c", të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*Ligji për Gjykatat Administrative*), të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të dërgonte çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë. Rekursi i është dërguar me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit gjykatës së apelit dhe pasi është pranuar prej saj është dërguar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

24. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 24.4.2023, ka vendosur: i. mospranimin e rekursit të paraqitur, me arsyetimin se kërkesa për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, haptazi nuk ngre asnjë shkak nga ato që parashikohen në nenin 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative; ii. caktimin e gjobës prej 50 000 lekësh ndaj kërkuесit, bazuar në nenin 34 të KPC-së, me arsyetimin se kërkesa është haptazi e pathemeltë dhe, për më tepër, abuzive (*shih paragrafët 14, 15 dhe 22, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

25. Kundër dënimit me gjobë kërkuesi ka paraqitur ankim, për të cilin i njëjti Kolegj Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 22.12.2023, ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se pretendimet e tij nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe prezumohet se përfaqësuesi ligjor i Avokaturës së Shtetit ka dijeni për ligjin dhe ka për detyrë të marrë të gjitha masat e duhura që të informojë të përfaqësuarit prej tij (*në rastin konkret palën e paditur*) dhe të veprojë vetëm në përputhje me interesat e tij pa shkelur ligjin, duke shmangur kërkesa të tilla të cilat nuk gëzojnë mbështetje ligjore dhe që ngarkojnë me përgjegjësi atë që ka për detyrë t'i evitojë. Po sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka treguar asnjë shkak ligjor për revokimin e vendimit të dënimit me gjobë, duke i vënë në dukje gjykatës pozitën e tij ligjore si avokat i shtetit, të cilën gjykata e ka vlerësuar në kohën e marrjes së vendimit (*shih paragrafin 10 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

26. Gjykata vëren se neni 34, pika 1, i KPC-së parashikon se gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur, ose shtrembëruar me keqbesim, ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jo përfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës.

27. Për sa i përket vendosjes së gjobave për abuzimin me të drejtat në procesin gjyqësor, Gjykata ka pohuar se ajo është një masë procedurale që synon të sigurojë administrimin e duhur të drejtësisë dhe ka për qëllim shmangien e abuzimeve me të drejtat në procesin gjyqësor, e cila i kundërdrejtohet palës ose përfaqësuesit të saj, kur me vetëdije paraqet kërkesa ose pretendime abuzive (*shih vendimin nr. 22, datë 4.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata, duke marrë shkas edhe nga shpjegimet e subjektit të interesuar për pasojat në drejtëm të së drejtës për ankim dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, evidenton se në vendosjen e gjobave të tilla, gjykatat e zakonshme kanë detyrim të shtuar, që në arsyetimin e vendimit, krahas mënyrës së zgjidhjes së çështjes të tregojnë me qartësi, jo vetëm ligjin e zbatueshëm për caktimin e gjobës, por edhe faktin konkret, në kuptimin se përse një sjellje e caktuar përbën abuzim me të drejtën. Në kontekstin e çështjes konkrete, Gjykata thekson se një detyrim i tillë për Gjykatën e Lartë merr rëndësi përcaktuese kur ajo vendos mospranimin e rekursit me arsyetimin se shkaqet janë haptazi të pabazuara në ligj dhe jo për shkaqe të tjera formale, objektivisht të verifikueshme, siç është ai i afatit ose legjitimitetit të rekursuesit. Në këto raste, Gjykata e Lartë, brenda funksionit kushtetues të saj, vlerëson çështjen duke ushtruar diskrecion mbështetur në aktet e dosjes gjyqësore dhe në interpretimin e ligjit, ndaj vlerësimi i mëtejshëm se paraqitja e rekursit ka qenë në abuzim me të drejtën për arsye të pathemelësisë së shkaqeve nuk mund të arsyetohet në mënyrë standarde, abstrakte dhe të kufizuar. Një arsyetim i tillë cenon balancën kushtetuese që duhet të ekzistojë midis së drejtës për të paraqitur rekurs dhe nevojës për të ruajtur procesin gjyqësor nga rekursit abuzive.

28. Gjykata vë në dukje se çështja, nëse shkaqet e rekursit janë ose jo haptazi të pabazuara në ligj, ka të bëjnë me vlerësimin e rekursit dhe fatin e tij nëse pranohet për shqyrtim ose jo. Mënyra e parashtrimit të shkaqeve ose kërkimeve, në radhë të parë, lidhet me cilësinë dhe nivelin profesional të hartimit të një rekursi të pranueshëm, që, si rregull, nuk mund të vlerësohet se përbën abuzim me të drejtën. Fati i pasuksesshëm i rekursit, në kuptim të rezultatit të tij, nuk mund të shoqërohet me gjobë, duke përdorur të njëjtin arsyetim të kufizuar se shkaqet e rekursit janë haptazi të pabazuara, pasi një qëndrim i tillë do të dekurajonte palët në ushtrimin e ankimit ose do të krijonte një barrë të tepruar për aksesin në gjykatë. Nëse Gjykata e Lartë vlerëson se përjashtimisht gjendet në situatën e abuzimit me të drejtën, duhet të analizojë konkretisht rrethanat e qarta objektive që dëshmojnë, gjithashtu, qëndrimin subjektiv keqdashës të rekursuesit për të shpërdoruar mjetin e rekursit.

29. Thënë sa më lart, Gjykata konstaton se arsyetimi i Gjykatës së Lartë në vendimin e datës 24.4.2023, se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi në rekurs “*është haptazi e pathemeltë dhe për më tepër abuzive*”, është i paarsyetuar, duke u mjaftuar vetëm me interpretimin se kur aplikohet neni 34, pika 1, i KPC-së, pa e lidhur zbatimin e tij me rrethanat e rastit në fjalë, por vetëm me faktin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative. Konkretisht, ndërsa arsyetimi i Gjykatës së Lartë për vlerësimin e shkaqeve të rekursit gjendet i pasqyruar vetëm në 4 paragrafë, të cilat, nga pikëpamja formale, duken të formuluar në mënyrë standarde (*shih paragrafët 11–14*), arsyetimi se kur gjen zbatim neni 34, pika 1, i KPC-së gjendet i pasqyruar në 8 paragrafë, në përmbajtje të të cilave jepet një shpjegim i detajuar i ligjit të zbatueshëm, procedura e dhënies dhe e ankimit ndaj gjobës, ndërsa mungojnë arsytet se përse rekursi konkret përbënte abuzim me të drejtën dhe sillte nevojën e caktimit të gjobës, si dhe ku qëndronte ndryshimi i atij rekursi në raport me një numër të lartë rastesh, në të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për pathemelësi të shkaqeve të ngritura, pa caktuar gjobë për abuzim me të drejtën (*shih paragrafët 15–22*). Me fjalë të tjera, arsyetimi i vendimit rezulton të jetë formal në kuptimin grafik dhe strukturor, duke e bërë atë të duket fiktiv.

30. Në vijim, Gjykata evidenton, gjithashtu, se të metat kushtetuese të mësipërme nuk janë korrigjuar nga Gjykata e Lartë në dhënien e vendimit të datës 22.12.2023, me të cilin nuk është pranuar kërkesa për revokimin e dënimit të gjobës, duke mos i dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuetit përse ishte vlerësuar paraqitja e rekursit prej tij abuzim me të drejtën në procesin gjyqësor, në kuptim të nenit 34, pika 1, të KPC-së.

31. Në përmbyllje të analizës së mësipërme, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në pjesën që ka caktuar gjobë ndaj kërkuetit, si dhe vendimi i mospranimit të ankimit ndaj tij, nuk plotësojnë standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe, si të tilla, duhen shfuqizuar.

32. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuetit janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2236, datë 24.4.2023, të Gjykatës së Lartë, për pjesën që ka vendosur dënimin me gjobë të kërkuetit, dhe vendimit nr. 00-2023-5594, datë 22.12.2023, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 17.10.2024.

Shpallur, më 14.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini

